
STATUT I SHOQËRISË ” Albo-Z Solare Energy Group” SH.P.K

Dispozita te Përgjithshme

Shoqëria me përgjegjesi te kufizuar ” Albo-Z Solare Energy Group”sh.p.k, eshte themeluar sipas aktit te themelimit dhe ketij statuti te perpiluara dhe nenshkruara nga ortaket e saj bazuar ne “Ligjin” Nr. 9901, dt. 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë tregtare”; i ndryshuar.

KREU 1

THEMELIMI ,EMRI ,OBJEKTI,KOHEZGJATJA ,SELIA

Neni 1

Themelimi dhe emertimi I shoqerise

1.1.Sot me date **02.07.2023**, ne ortaket themelues vendosem me vullnet te lire e te plote te themelojme nje shoqeri me përgjegjesi te kufizuar .Shoqëria do te kete emrin” **Albo-Z Solare Energy Group”sh.p.k**. Shoqëria fiton personalitet juridik me regjistrimin e saj në Regjistrin Tregtar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit.

1.2.Ortaket themelues te shoqerise jane:

- **Z.Pjerin Laloshi** , atësia Kol dhe amësia Verenika , i datëlindjes 27/01/1990 , lindur në Shkoder , shtetas shqiptar, banues në adresën: “Beltoje ”, Nd nr. 34 hyrja 1 Berdice , Shkoder , madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtës i Letërnjoftimit me numër 036570604 dhe numër personal J00127035B,

Neni 2

Selia

2.1.Selia Qendore e Shoqërisë është në adresen: Shkoder , Rruga Beltoje-Mali-Hebaj Nr banese 14 ,njeisa administrative Berdice .

2.2.Shoqëria mund te hapë dhe mbajë zyra dhe/ose të kryejë aktivitete në vende të tjera,brenda ose jashtë Republikës se Shqipërisë, si dhe të hapë ose mbyllë zyra ne vende të ndryshme, pervec selisë së Shoqërise, brenda territorit shqiptar.

Neni 3

Kohezgjatja

3.1. Kohezgjatja e shoqerise eshte per nje periudhe te pacaktuar kohe.

Neni 4

Objekti

4.1. Objekti i shoqërise do të konsistoje ne :

- Aktivitete në fushën e Import-eksport , ndertimi ,operimi dhe transferimi I centraleve ku perfshihen :financimi,projektimi,ndertimi,venia ne pune,prodhimi, furnizimi, transmetimi,shperndarja dhe shitja e energjise elektrike ,energji e prodhuar nga mullinjte me ere. Importi dhe venia ne perdorim e turbinave, paneleve diellore per prodhimin e energjise te te gjitha llojeve dhe pajisjeve qe lidhen me to.Importi dhe venia ne perdorim,eksportimi dhe shitja e energjise elektrike ne zbatim te kontrates koncesionare,makinerive ,pajisjeve dhe materialeve te para te nevojshme per prodhimin e energjise se te gjitha llojeve .Shoqeria kryen cdo lloj veprimtarie te dobishme per arritjen e objektit te saj ,duke perfshire edhe pjesemarrjen ne kuota dhe aksione ne shoqeri e ndermarrje te tjera. Veprimtari ne fushen e ndertimit e projektimit , punime ne fushen e ndertimit te te gjitha llojeve te punimeve , ndertimi I objekteve te reja si dhe restaurimit te objekteve te ndryshme ,veprimtari imobiliare per shitje e blerje etj

Shoqeria mund të kryejë cdo aktivitet tjetër biznesi i cili nuk është i ndaluar nga ligji I zbatueshëm në Republikën e Shqipërise.

KREU II

KAPITALI

Neni 5

Kapitali themeltar

5.1.Kapitali themeltar I shoqerise eshte **100.000 leke(njeqindmije leke) I ndare ne 1 kuote , sipas pjesemarrjes se themeluesve ne kapitalin e shoqerise ne perputhje me kontributet si me poshte:**

Z. Z.Pjerin Laloshi , atësia Kol dhe amësia Verenika , i datëlindjes 27/01/1990 , lindur në Shkoder , shtetas shqiptar, banues në adresën: “Beltoje ”, Nd nr. 34 hyrja 1 Berdice , Shkoder , madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtës i Letërnjoftimit me numër 036570604 dhe numër personal J00127035B, zoteron **1 kuote** me pjesemarrje ne kapitalin themeltar te shoqerise **prej 100%**(njeqind perqind).

5.2.Kuotat jane të zakonshme dhe lirisht të transferueshme sipas kushteve të parashikuara në ligj dhe këtë Statut. Kuotat e kapitalit shoqërise e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;
- b) shitblerjes;
- c) trashëgimisë;
- ç) dhurimit;
- d) çdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj.

Në rastin e kalimit të kuotave me kontratë, kontrata duhet të bëhet me shkrim.

5.3. Ortaku mban përgjegjësi të kufizuar në marrëdhëniet juridike – civile me të tretet, përgjegjësi që kufizohet deri në vlerën e pashlyer të kontributit të nënshkruar prej tij.

Neni 6

Zmadhimi dhe zvogelimi I kapitalit themelar

6.1. Organi vendimarrës për zmadhimin dhe zvogelimin e kapitalit të regjistruar të shoqërisë është Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve.

6.2. Kapitali I shoqërisë mund të zmadhohet nëpërmjet nënshkrimeve të pjesëve të kapitalit themeltar për kontributet në para dhe me anë të kontributeve në natyrë përmes emërimit nga gjykata kompetente të një eksperti të autorizuar për këto kontribute sipas kërkesës së administratorit .

Në asnjë rast shumica nuk mund të detyrojë një ortak për të rritur angazhimin e tij në kapitalin themeltar të shoqërisë por vetë ortaku pranon rivlerësimin e pjesës së tij takuese në shoqëri në proporcion me rritjen e kapitalit.

Zvogelimi I kapitalit lejohet nga asambleja e përgjithshme e ortakëve e cila merr vendim në të njëjtat kushte që kërkohej për ndryshimin e statutit.

Në të gjitha rastet zvogelimi I prek ortakët në të njëjten masë ndaj pjesëve të kapitalit që përfaqësojnë.

Neni 7

Vdekja e Ortakëve

7.1 Kuotat e Ortakëve mund të transferohen lirisht tek trashëgimtarët ligjorë e testamentarë të tyre mbas vdekjes. Ortakët e mbetur mund të ushtrojnë të drejtën e parablerjes në rast shitje të të njëjtave si pasojë e mungesës së vullnetit të trashëgimtarëve për të hyrë në vend të vdekurit

Neni 8

Transferimi I kapitalit

8.1 Ortakët kanë të drejtën të transferojnë lirisht kuotën që zotërojnë në kapitalin e regjistruar të shoqërisë, mes të gjallëve kundrejt pagesës së një shume; gjithsesi, ortakëve të tjerë I përket e drejta e parablerjes së kuotës së kapitalit të Ortakut shitës, në rast shitje-blerje të saj.

8.2 Për të respektuar të drejtën e parablerjes të Ortakëve të tjerë, Ortaku që ka ndërmend të shesë, tërësisht apo pjesërisht kuotën e tij të kapitalit të regjistruar, duhet të komunikojë qëllimin rekomandë, drejtuar Ortakëve të tjerë dhe secilit prej administratorëve të Shoqërisë. Ortakët, 30 ditë pas marrjes së lajmërimit (të saktësuar në fletë-marrë postare), mund të ushtrojnë të drejtën e tyre të parablerjes, me të njëjtat kushte siç u është komunikuar, gjithmonë përmes letrës rekomandë drejtuar Ortakut që shpreh dëshirën për shitjen e kuotës. E drejta e parablerjes duhet ushtruar për të gjithë kuotën në fjalë

8.3 Pasi të kenë kaluar 30 ditë nga njoftimi dhe asnjëri nga ortakët nuk ka ushtruar të drejtën e parablerjes së kuotës së kapitalit, Ortaku shitës është i lirë t'ia transferojë palëve të treta kuotën e tij, me të njëjtat kushte që ua kishte ofruar ortakëve të tjerë të shoqërisë.

8.4 Nëse më shumë se një nga Ortakët shpreh dëshirën të ushtrojnë të drejtën e parablerjes së kuotës së kapitalit në shitje, kuota do të ndahet në mënyrë të përpjeshtme me kuotat e tyre ekzistuese.

KREU III

ORGANET VENDIMARRESE DHE DREJTUESE TE SHOQERISE

Neni 9

Organet e shoqërisë Asambleja e Përgjithshme e Ortakeve, Administratori

9.1. Shoqëria është e organizuar në organet e saj drejtuese të cilat janë:

- 1-Asambleja e Përgjithshme e Ortakeve
- 2-Administratori

9.2. Asambleja e Ortakeve është organi i vetëm vendimarrës i shoqërisë dhe merr vendime kur është mbledhur rregullisht, në përputhje me ligjin dhe me Statutin vendime të cilat janë të detyrueshme për të gjithë ortakët përfshirë ata që mungojnë.

9.3. Kompetencat e Asamblese së Përgjithshme të Ortakeve, janë si më poshtë:

- a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë
- b) ndryshimet e statutit;
- c) emërimin e shkarkimin e administratorëve;
- ç) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- d) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat "c" dhe "ç" të kësaj pike;
- dh) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- ë) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- f) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- g) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- gj) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- h) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- i) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.

9.4. Asambleja e Përgjithshme mbledhet në rastet e parashikuara nga Statuti, nga ligji në fuqi "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", ligje të tjera dhe sa herë është e nevojshme për mbrojtjen e interesave të Shoqërisë.

Neni 10

Mbledhja e Asamblese së Përgjithshme të Ortakeve, kuorumi, marrja e vendimeve

10.1. Asambleja e përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi me shkresë ose me njoftim nëpërmjet postës elektronike. Njoftimi me shkresë apo me mesazh elektronik duhet të përmbajë vendin, datën, orën e

mbledhjes dhe rendin e ditës e t'u dërgohet të gjithë ortakëve, jo më vonë se 7 ditë përpara datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë.

Kur asambleja e përgjithshme nuk është thirrur sipas pikës 1 të këtij neni, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse të gjithë ortakët janë dakord, për të marrë vendime, pavarësisht parregullsisë.

10.2. Secili ortak ka të drejtën e pjesëmarrjes dhe votimit në mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme. Cdo ortak ka të drejta vote në përfaqësim me vlerën nominale të kuotes së tij.

10.3. Secili ortak mund të përfaqësohet në mbledhjet e Asamblese nga një ortak tjetër apo nga një person i tretë me autorizim, i cili jepet në formë shkresore vetëm për një mbledhje dhe është i vlefshëm edhe për mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.

10.4. Në rastin e marrjes së vendimeve që kërkojnë një shumicë të zakonshme, Asambleja e Përgjithshme merr vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejta vote, që zoterojnë më shumë se 30% të kuotave. Në rastin kur Asambleja duhet të vendosë për çështje që kërkojnë shumicë të kualifikuar ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse janë të pranishëm ortakët që zoterojnë më shumë se 50% të kuotave apo votojnë me shkresë ose me mjete elektronike.

10.5. Asambleja e Përgjithshme vendos me tre të katërtat e votave të ortakëve pjesëmarrës për:

- zmadhimin dhe zvogelimin e kapitalit
- ndryshimin e statutit
- shpërndarjen e fitimeve
- prishjen dhe riorganizimin e shoqërisë.

Asambleja e Përgjithshme vendos me shumicën e votave të ortakëve pjesëmarrës për çështje të tjera.

Neni 11

Administratori

11.1. Organi vendimarrës i shoqërisë, Asambleja e Ortakëve emeron me shumicë të thjeshtë një ose më shumë persona fizikë si administratorë të shoqërisë.

11.2. Afati i emerimit është 5 vjet me të drejta ripërteritje. Emerimi i administratorit prodhon efekte vetëm pas Regjistrimit në Qendren Kombëtare të Biznesit.

11.3. Administratori/ët shkarkohet/n nga detyra, në çdo kohë, me vendim të marrë me shumicë të thjeshtë nga Asambleja.

11.4. Administrator i shoqërisë emerohet z. **Z. Pjerin Laloshi**, atësia Kol dhe amësia Verënika, i datëlindjes 27/01/1990, lindur në Shkoder, shtetas shqiptar, banues në adresën: "Beltoje", Nd nr. 34 hyrja 1 Berdica, Shkoder, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtës i Letërnjoftimit me numër 036570604 dhe numër personal J00127035B madhor me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar.

Emerohet për një afat 5 vjeçar me të drejta ripërteritje. Administratori mund të shkarkohet me shumicë të thjeshtë nga Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve.

Neni 12

Kompetencat e administratorit.

12.1. Administratori i shoqërisë ka detyra të :



-
- a) kryejë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
- b) përfaqësojë shoqërinë tregtare;
- c) kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
- ç) përgatit dhe nënshkruan bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqet këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim;
- d) krijon një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
- dh) kryen regjistrimet dhe dërgon të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Biznesit;
- e) raporton përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;
- ë) kryen detyra të tjera të përcaktuara në ligj

12.2. Nëse asambleja e përgjithshme emëron më shumë se një administrator, ata e administrojnë bashkërisht shoqërinë.

12.3. Shpërblimit bazë të administratorëve mund t'i bëhen shtesa, që mund të jenë përqindje në fitim ose të ngjashme. Shpërblimet e administratorëve përcaktohen me vendim të zakonshëm të asamblesë së përgjithshme.

Neni 13

Përgjegjësia e Administratorit

13.1. Pasojat e marrëveshjeve të pamiratuara nga asambleja që i sjellin dëm shoqërisë, i ngarkohen administratorit dhe ortakut që ka bërë marrëveshjen, për të përballuar në mënyrë individuale ose solidarisht sipas rastit pasojat përkatëse.

Përveç sa është parashikuar në dispozitat e përgjithshme të detyrimit të besnikërisë, sipas neneve 14, 15, 17 e 18 të ligjit "Per Tregtaret dhe Shoqëritë Tregtare" administratori detyrohet:

- a) të kryejë detyrat e tij të përcaktuara në ligj dhe në statut në mirëbesim e në interesin më të mirë të shoqërisë në tërësi, duke i kushtuar vëmendje të veçantë ndikimit të veprimtarisë së shoqërisë në mjedis;
- b) të ushtrojë kompetencat që i njihen në ligj dhe në statut vetëm për arritjen e qëllimeve të përcaktuara në këto dispozita;
- c) të vlerësojë me përgjegjësi çështjet, për të cilat merret vendim;
- ç) të parandalojë dhe mënjanojë rastet e konfliktit, prezent apo të mundshëm, të interesave personale me ata të shoqërisë;
- d) të ushtrojë detyrat e tij me profesionalizmin dhe kujdesin e nevojshëm.

13.2. Administratori, duhet te kryejë detyrat e tij duke ndjekur interesin me te larte te shoqerise.

13.3. Nëse administratori vepron në kundërshtim me detyrat dhe shkel standardet profesionale, sipas pikave 1 e 2 të këtij neni, është i detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet, që rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe t'i kalojë çdo fitim personal që ai apo personat e lidhur me te kanë realizuar nga këto veprime të parregullta. Administratori ka barrën e provës për të vërtetuar kryerjen e detyrave të tyre në mënyrë të rregullt e sipas standardeve të kërkuara. Kur shkelja është kryer nga më shumë se një administrator, ata përgjigjen ndaj shoqërisë në mënyrë solidare. Përveç padisë për shlyerjen e dëmit që i ngarkohet personalisht administratorit, ortakët individualisht ose se bashku, kanë të drejtë të ngrenë padi penale kundër administratorit

Paditësit kanë të drejtë të ndjekin në rrugë ligjore shlyerjen e plotë të dëmit që i është shkaktuar shoqërisë, përfshirë edhe dëmshpërblimin financiar, nëse është e nevojshme. Asnjë vendim i asamblesë nuk mund të ndalojë ngritjen e kërkesë padisë kundër administratorit për gabimet e kryera prej tij gjatë ushtrimit të detyrës.

KREU IV

VITI FINANCIAR –EKSPERTET

Neni 14

Viti financiar

Viti financiar i Shoqerise fillon me 1 Janar dhe perfundon me 31 Dhjetor. Perjashtimisht, viti i pare financiar fillon nga data e regjistrimit te shoqerise ne Qendren Kombetare te Biznesit dhe mbyllet me 31 Dhjetor.

Neni 15

Ekspertet

Eksperti ka per detyre qe te kontrolloje te gjithë dokumentacionin kontabel të veprimtarise ekonomiko tregtare të shoqerise, ate vjetor dhe ate ne lidhje me kontrollet periodike të ushtruara prej tij per rastet kur ai eshte ngarkuar dhe ka kryer nje gje të tille i ngarkuar nga ana e ortakeve.

Ne perfundim të kontrollit eksperti kontabel i autorizuar pergatit raportin me shkrim per nxjerrjen e rezultatit të bilancit financiar vjetor si dhe per ate per kontrollet periodike të ushtruara, të cilat eshte i detyruar qe t'ja paraqese e dorezoje ne kohe ortakeve per t'i shqyrtuar e miratuar .

KREU V

PRISHJA –RIORGANIZIMI I SHOQERISE

Neni 16

Prishja dhe Likuidimi

Shperndarja ose prishja e shoqerise mund të behet ne cdo kohe :

- a) kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelimin e saj;
- b) me perfundimin e procedurave te falimentimit apo ne rast te pamjaftueshmerise se pasurive per te mbuluar shpenzimet e procedures se falimentimit.;

c)ne rast se objekti behet I perealizueshem per shkak te mosfunksionimit te vazhduar te organeve te shoqerise apo per shkaqe qe bejne absolutisht te pamundur vazhdimin e veprimtarise tregatre

d)ne rastet e pavlefshmerise se themelimit

e)ne raste te tjera te parashikuara ne ligj

f)per cdo shkak tjeter te vendosur nga Asambleja e Ortakeve

15.1.Ne kete rast Ortaket marrin vendim me shkrim ne të cilin parashikojne menyren e likuidimit të shoqerise, duke caktuar 1 apo disa likuidatore dhe shenuar ne cdo dokument të nxjerre prej tij emrin e likuidatorit dhe emertesën shtese “ Shoqeri ne likuidim e siper “.

15.2.Prishja e shoqërive tregtare ka si pasojë hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë paguese, me përjashtim të rasteve kur është nisur një procedurë falimentimi.

15.3.Likuidimi kryhet nga likuiduesit e emëruar nga Asambleja e Ortakeve te shoqerise.

Neni 17

Riorganizmi i shoqërisë bashkimi-ndarja

16.1.Shoqëria mund të ndahet, bashkohet sipas Vendimit të Asamblesë së Ortakëve, në përputhje me dispozitat ligjore të parashikuara në Pjesën IX të Ligjit 9901 datë 14.04.2012 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, I ndyshuar.

Neni 18

Baza Ligjore

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e saj ne perputhje te plote me kete statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar. Per sa nuk parashikohet ne kete statut, do te zbatohen dispozitat e ligjit "Per tregtarët dhe shoqëritë tregtare", Kodit Civil dhe çfaredo ligji ne Republikën e Shqiperise.

Neni 19

Zgjidhja e mosmarreveshjeve

Per zgjidhjen e mosmarreveshjeve qe kane te bejne me interpretimin e ketij statuti apo ato qe mund te lindin midis ortakeve apo ortakeve dhe te treteve ,kompetente per keto do te jete Gjykata e Rrethit Gjyqesor Tirane.

Statuti hartohet ne 3 (tre) kopje ne gjuhen shqipe,me vlere te njejte ligjore.

Ky statut pasi u lexua dhe u kuptua nga palet nenshkruhet prej tyre me vullnet te lire,te plote e te pavesuar.

ORTAKET THEMELUES TE SHOQERISE

Z. Z.Pjerin Laloshi

PJERIN LALOSHI 